

# Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj



# Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat

Prishtinë, 2018

E drejta e autores © 2018. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimit të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret sërish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo mjeti tjetër, pa lejen paraprake të D4D-së.

Punim i përgatitur nga:

Vjollca Krasniqi

Lista e kontribuesve:

Demokraci për Zhvillim (D4D)

Syri i Vizionit

Fondacioni IPKO

Termokiss

Anibar

EC MA Ndryshe

Young Active Graçanica

SHL Kosova

Ky dokument pozicionues është hartuar si pjesë e projektit “Vullnetarizëm për Zhvillim: Promovimi i vullnetarizmit dhe i aktivizmit qytetar në Kosovë”, që implementohet nga Demokraci për Zhvillim në partneritet me George William Youth Association në Kosovë, e financuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë. E gjithë përmbajtja e këtij publikimi i përfaqëson pikëpamjet e autorëve dhe jo domosdoshmërisht i pasqyron pikëpamjet e Ambasadës Britanike në Prishtinë.

## Pasqyra e lëndës

Akronimet.....	6
Përmbledhje ekzekutive .....	7
Hyrje .....	9
Metodologjia.....	10
Vullnetarizmi: Konteksti i Kosovës.....	11
Spektori i vullnetarizmit në Kosovë në perspektivë krahasuese rajonale.....	13
Mjedisi social dhe dinamikat e vullnetarizmit në Kosovë ...	16
Motivimi për vullnetarizëm: Vlera kundrejt motiveve individuale.....	18
Rekomandimet .....	21
<i>Qeveria e Kosovës</i> .....	21
<i>Shoqëria civile</i> .....	21
Përfundim.....	23
Lista e publikimeve .....	24
Referencat.....	28

## Akronimet

OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
BE	Bashkimi Evropian
DGF	Diskutimi në grupin e fokusit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OJQ	Organizatë joqeveritare
EJL	Evropa Juglindore
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

---

## Përmbledhje ekzekutive

Sot, siç kanë treguar të dhënat e hulumtimit, vullnetarizmi po bëhet gjithnjë e më popullor në shoqëri për shkak të numrit në rritje të projekteve, të organizatave dhe të rrjeteve vullnetare. Në të vërtetë, vullnetarizmi ka mbetur kryesisht në lëmin e organizatave jo-qeveritare (OJQ) dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC). Më shumë se një e treta e kosovarëve kanë qenë të përfshirë në ndonjë aksion vullnetar diku në vitin e kaluar. Niveli më i lartë i vullnetarizmit është në mesin e rinisë. Megjithatë, jo të gjitha grupet shoqërore janë të përfshira në mënyrë të barabartë në vullnetarizëm. Është vërejtur një boshllëk gjinor që tregon vazhden e nën-përfaqësimit të grave në çështjet publike dhe ato të komunitetit. Përveç kësaj, nga të gjitha grupet etnike në Kosovë, vullnetarizmi është dukshëm më i ulët në radhët e serbëve të Kosovës (Anketa 2017 e D4D-së).

Në Kosovë, sikurse edhe në vendet e tjera të Evropës Juglindore (EJL), vullnetarizmi është bërë pjesë e politikës publike. Ai ka marrë një rol në kuadër të politikave për rini. Për më tepër, vullnetarizmi është bërë prioritet i politikave si pjesë e strategjisë së shtetit për bashkëpunim me shoqërinë civile. Megjithatë, politikat e vullnetarizmit ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm për t'i zgjeruar hapësirat për një qytetari të angazhuar. Rritja e shkallës së vullnetarizmit frymëzon një nivel më të lartë të pjesëmarrjes qytetare dhe të bashkëveprimit ndërmjet faktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, duke sjellë me vete potencialin për një Kosovë më përfshirëse në aspektin shoqëror.

Në përgjithësi, vullnetarizmi kuptohet në terma altruistë. Të dhënat e anketës po ashtu kanë treguar se motivimi kryesor për vullnetarizëm ka të bëjë me interesin publik që pasohet nga motivimi individual, domethënë, duke kërkuar rritjen e kapitalit social, të arsimimit dhe të perspektivës së

punësimit. Për më tepër, hulumtimi ka zbuluar se përfitimet nga vullnetarizmit perceptohen të jenë sociale, individuale dhe organizative (Anketa 2017 D4D). I kuptuar kështu, vullnetarizmi ofron një platformë për lidhjen e kapitalit social, rritjen e besimit dhe nxitjen e vendim-marrjes demokratike. Në këtë material diskutohen çështjet e politikave, sfidat dhe mundësitë për vullnetarizëm në Kosovë. Duke u fokusuar në mjedisin institucional dhe shoqëror, është kërkuar që të identifikohen boshllëqet dhe mundësitë për të promovuar aksionin vullnetar. Në këtë punim theksohet nevoja për ndërhyrje me politika për të mbështetur vullnetarizmin ndaj nismave me bazë në komunitet, si dhe për të përmirësuar ndërveprimin e qytetarëve me shtetin, shoqërinë civile dhe sektorin e biznesit.



## Hyrje

Vullnetarizmi<sup>1</sup> nuk është një fenomen i ri për qytetarët e Kosovës. Ai është i ngulitur në praktikat shoqërore dhe në idetë e Kosovës si një komunitet i përbashkët. Megjithatë, si në shumë fusha të tjera shoqërore, vullnetarizmi është duke u zhvilluar, duke bartur potencial për konsolidim demokratik dhe kohezion social. Vullnetarizmi bazohet në të drejtat e qytetarisë si parakusht për një demokraci që funksionon mirë, ku sundimi i ligjit zbatohet brenda sferës së institucioneve dhe të jetës së përditshme.

Sot, vullnetarizmi është pjesë e politikave publike dhe përfshihet në agjendën e sektorit të shoqërisë civile. Në të vërtetë, OSHC-të kanë luajtur një rol të konsiderueshëm në promovimin dhe drejtimin e projekteve të vullnetarizmit në Kosovë. Ndonëse është bërë njëfarë progresi në këtë fushë, një numër sfidash dhe pengesash vazhdojnë të pengojnë një zhvillim më të plotë të vullnetarizmit.

Objektivi i këtij materiali është i dyfishtë; i pari, që të identifikoj mundësitë dhe sfidat e mundshme që mund të lindin për vullnetarizmin dhe i dyti, që të jepen një sërë rekomandime specifike për institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe sektorët e biznesit, për të adresuar boshllëqet në politikat dhe praktikat e vullnetarizmit në Kosovë.

---

<sup>1</sup> Termet si vullnetarë, vullnetarizëm dhe aksion vullnetar përdorën në vend të punës vullnetare për të shmangur lidhjen me punën me pagesë.

## Metodologjia

Ky studim bazohet në të dhëna sasiore dhe cilësore që rrjedhin nga një anketë e zhvilluar në mbarë Kosovën, diskutimet e fokus grupeve (DFG), dhe një rishikim i dimensioneve të politikave që kanë të bëjnë me vullnetarizmin. Anketa bazohet në 1,065 intervista *ballë për ballë* me të anketuarit e moshës 18+ vjeçare nga të gjitha grupet etnike, duke përfshirë këto komunitete: shqiptarë të Kosovës, serbë të Kosovës, boshnjak , goranë , turq dhe rom. Grumbullimi i të dhënave u krye në dhjetor të vitit 2017. Pyetjet trajtonin tema që lidhen me praktikën e vullnetarizmit brenda periudhës kohore të 12 muajve të fundit; motivet dhe fushat e vullnetarizmit; si dhe pjesëmarrjen qytetare. Të dhënat e anketës së vitit 2017 u krahasuan me rezultatet e anketës së vitit 2016. Qëllimi ka qenë identifikimi i tendencave krahas niveleve të motivimit dhe hapësirat për vullnetarizmin e ardhshëm.

Anketa ofronte një gamë të gjerë të të dhënave mbi vullnetarizmin sipas gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, arsimit, statusit të punësimit dhe llojit të banimit. Megjithatë, analiza e paraqitur këtu ka pasur një fokus të veçantë mbi vullnetarët nga shtresat e ndryshme socio-ekonomike. Për të eksploruar më thellë dhe për të kuptuar më mirë praktikën dhe motivimet e vullnetarëve, u zhvilluan dy DFG me vullnetarë me përvojë dhe një tjetër me vullnetarë të mundshëm. Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në DFG-të janë nxjerrë nga të dhënat e anketës mbi shkallën e incidencës së praktikës vullnetare dhe nivelin e motivimit për aksion vullnetar. DFG –të ndoqën një qasje gjysmë të strukturuar me një listë të pyetjeve paraprake për të orientuar diskutimin mbi kornizat shoqërore, perceptimet, motivimin dhe pjesëmarrjen në vullnetarizëm. DFG-të u mbajtën në janar të vitit 2018.

## Vullnetarizmi: Konteksti i Kosovës

Në Kosovë, vullnetarizmi ka qenë i formësuar nga zhvillimet politike dhe shoqërore në periudhat e post-socializmit, luftës dhe periudhat e rindërtimit të pasluftës. Trashëgimia e shtetit socialist, e konfliktit dhe e ndërtimit të institucioneve pasluftës - përbënin mundësi dhe sfida për vullnetarizmin. Gjatë viteve 1990-ta, Kosova e mbante veten përmes vullnetarizmit brenda një varg institucionesh paralele. Në të vërtetë, vullnetarizmi mbizotëronte në fushat e ekonomisë, politikës dhe të jetës së përditshme (Clark 2000). Në periudhën e pasluftës, vullnetarizmi ra në mënyrë të konsiderueshme. Hulumtimi tregoi se në periudhën e pasluftës shumica e kosovarëve i jepte rëndësi vullnetarizmit vetëm në lidhje me rezultatet e prekshme afatshkurtra individuale dhe me përfitim (UNDP 2004, p.50). Rënia e vullnetarizmit sinjalizoi pakësimin e besimit social në Kosovë.

Zhvillimi i shoqërisë civile është bërë i mundur nga disponueshmëria e fondeve nga donatorët si pjesë e rindërtimit të pasluftës dhe ndërtimit të institucioneve. Numri gjithnjë e më i madh i OJQ-ve, si ndërkombëtare ashtu edhe vendore, kërkonin mënyra për të rritur angazhimin qytetar, përfshirë angazhimin vullnetar. Sigurisht që OJQ-të dhe OSHC-të kanë qenë në qendër të angazhimit qytetar dhe aksionit vullnetar.

Një përparim i madh është institucionalizimi i vullnetarizmit ashtu që u bë pjesë e Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë (Ligji Nr. 03 / L-145, 2009). Siç përcaktohet në ligj, vullnetarizmi është një mënyrë për të rritur pjesëmarrjen e të rinisë në vendim-marrje dhe në arsimimin joformal. Ligji e përcakton vullnetarizmin si përfitim për shoqërinë dhe aftësim të të rinjve për t'i rritur perspektivat e tyre, për t'i përmirësuar aftësitë dhe përvojat profesionale (neni 14). Për më tepër, vullnetarizmi është

bërë pjesë e Strategjisë së Kosovës për Rininë 2013-2017, të Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sporteve dhe strategjisë së shtetit të Kosovës për bashkëpunim me shoqërinë civile (shih Strategjinë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2013-2017 të Zyrës për Qeverisje të Mirë).

Brenda kuadrit ligjor, vullnetarizmi parashikohet si maksimalizim i potencialit të rinisë. Sidoqoftë, ai dështon në kapërcimin e praktikave të vullnetarizmit të qytetarëve në tërë spektrin e moshës. Akterët e shoqërisë civile janë në kërkim të mënyrave të reja për të përmirësuar politikat e vullnetarizmit, mjedisin institucional dhe shoqëror, në mënyrë që t'u lejojë vullnetarëve nga mosha të ndryshme, me prejardhje etnike dhe socio-ekonomike, si dhe fusha të interesit që të angazhohen në aktivitete të vullnetarizmit në dobi të publikut në Kosovë.

## Sektori i vullnetarizmit në Kosovë në perspektivë krahasuese rajonale

Aksioni vullnetar është gurë themel i angazhimit qytetar. Vullnetarizmi përfshin përgjegjësinë qytetare. Ai rrit pjesëmarrjen qytetare dhe vendim-marrjen në çështjet që ndikojnë në jetën e komunitetit. Vullnetarizmi kontribuon në zhvillimin e kulturës së reciprocitetit dhe të solidaritetit. Rritja e vullnetarizmit është tregues i një ndërveprimit të zgjeruar midis shtetit dhe qytetarisë së saj. Kjo mund të jetë një masë e qeverisjes së mirë dhe e zhvillimit të shoqërisë civile. Në Kosovë, ka filluar të shfaqet hulumtimi mbi vullnetarizmin. Studimet sa u përket veprimit të politikave janë kryer nga disa OJQ (Sutaj dhe Vidačak 2017, GAP 2017, Hoxha 2016, Çeku 2013) ku theksohet potenciali i vullnetarizmit për konsolidimin demokratik dhe përfshirjen sociale.

Vullnetarizmi përfshin një numër të madh aktiviteteesh në nivel lokal, kombëtar dhe transnacional. Në të njëjtën kohë, vullnetarizmi është specifik sa i përket kontekstit. Niveli i angazhimit në aksion vullnetar dallon nëpër shtete të EJT-së. Në përgjithësi, numri i qytetarëve, të cilët paraqiten vullnetarë, mbetet i ulët. Në Bosnje dhe Hercegovinë, kjo arrin në katër përqind, në Serbi në pesë përqind dhe në Maqedonia në shtatë përqind (Gallup 2016, fq.9). Në Kosovë, shkalla e vullnetarizmit gjatë 2016 arriti në 15 përqind (Sutaj dhe Vidačak 2017, f. 61).

Indeksi i Shoqërisë Civile 2016 në Kosovë tregoi se 60 përqind e OShC-ve angazhojnë vullnetarë në punën e tyre. Megjithatë, ndryshojnë llojet e angazhimit të vullnetarëve brenda OShC-ve. Ato kryhen nëpërmjet mënyrave formale dhe joformale. Më shumë se një e treta e OSHC-ve kanë angazhuar vullnetarë përmes kontratave formale; 25 përqind nëpërmjet marrëveshjeve verbale; 32 përqind konsiderojnë se nuk ka nevojë për kontratë për shkak të

kohëzgjatjes së shkurtër të aksionit vullnetar; dhe 5 përqind nuk i shohin kontratat si të rëndësishme pasi që ato nuk janë të detyrueshme me ligj (Hoxha 2016, f. 57).

Vendet e Evropës Juglindore e aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE). Si pjesë e procesit të integrimit evropian, Kosova dhe vendet fqinje po i zbatojnë reformat institucionale dhe ligjore. Kjo ka ndikuar edhe në politikën e vullnetarizmit. Vendet në rajon kanë miratuar ligje për vullnetarizmin (Kroacia 2007, Maqedonia 2007, Bosnja dhe Hercegovina 2008, Serbia 2010, Mali i Zi 2010, Sllovenia 2011 dhe së fundi Shqipëria, e cila miratoi një ligj për vullnetarizmin në vitin 2016 (Sutaj dhe Vidačak 2017, fq.61). Me legjisllacionin mbi vullnetarizmin kërkohet të kapërcehet hendeku ndërmjet shtetit, shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit përmes aksionit vullnetar për të mirën publike (Sutaj 2017, f. 20).

Duke parë kuadrin ligjor dhe institucional, në kontekstin rajonal, është evidente që vullnetarizmi definohet si një angazhim i papaguar individual në dobi të interesit publik. Por ajo çfarë e dallon Kosovën në kuadrin ligjor nga vendet e tjera të rajonit është përcaktimi i saj i vullnetarizmit nga perspektiva e të rinjve dhe më pas siç është theksuar më parë, i rregulluar me ligjin për rininë (Ligji për Rininë 2009). Në kontrast me Kosovën, vendet fqinje nuk kanë vendosur kufizime moshore sa i përket vullnetarizmit, duke zgjeruar vullnetarizmin në të gjithë spektrin e moshës, duke lejuar bashkëveprimin e individëve dhe grupeve me prejardhje të ndryshme.

Sfidat që lidhen me zhvillimin politik, ekonomik dhe social në Kosovë kanë pasur një ndikim të thellë në rininë, pasi që Kosova ka popullatën më të re në Evropë. Shkalla e papunësisë së të rinjve në Kosovë është më e larta në Evropë. Në 2016, papunësia e të rinjve ishte 52.4 përqind. Papunësia e të rinjve në mesin e femrave është më e lartë (65.4 përqind) sesa tek meshkujt (47.2 përqind) (Agjencia e

---

Statistikave të Kosovës 2016, f.10). Kështu që, vullnetarizmi si prioritet në kuadër të politikave rinore është një mënyrë për të trajtuar papunësinë e të rinjve, pasi që vullnetarizmi mund t'i pajisë vullnetarët me aftësitë e nevojshme për të gjetur punë.

Sot OSHC-të në Kosovë janë duke avokuar për një ligj të veçantë për vullnetarizmin. Në të vërtetë, 87.4 përqind e përfaqësuesve të OSHC-ve kanë mbajtur qëndrimin se vullnetarizmi duhet të rregullohet me ligj. Për më tepër, ato besojnë se vullnetarizmi nuk duhet të kufizohet vetëm tek të rinjtë. Ato e perceptojnë këtë si kufizim dhe një nga barrierat kryesore në zhvillimin e vullnetarizmit krahas mungesës së rregulloreve që lidhen me të drejtat dhe përgjegjësitë, stimujt dhe përfitimet për vullnetarët dhe organizatat (Sutaj dhe Vidačak 2017, fq . 44-45). (Sutaj and Vidačak 2017, pp. 44-45).

## Mjedisi social dhe dinamikat e vullnetarizmit në Kosovë

Vullnetarizmi po bëhet mënyrë kuptimplote për ndërveprim social për qytetarët në jetën e tyre të përditshme. Më shumë se një e treta e kosovarëve janë angazhuar në vullnetarizëm gjatë dy viteve të fundit; 38.5 përqind në vitin 2016 dhe me një rënie në 32.7 përqind në 2017 (Sutaj dhe Vidaçak 2017, faqe 11). Sa i përket përkatësisë etnike, anketa e vitit 2017 ka treguar se nga 13.3 përqind e të anketuarve që deklaruan se kishin dalë vullnetarë në tre muajt e fundit, 27.4 përqind janë pjesëtarë të komuniteteve të tjera etnike, krahasuar me 14 përqind të shqiptarëve dhe vetëm 0.7 përqind e serbëve (shih Figurën 1). Jo të gjithë vullnetarët marrin pjesë në mënyrë të barabartë. Të dhënat nga hulumtimi tregojnë, megjithatë, se vullnetarizmi ndryshon në bazë të gjinisë. Gratë kanë një nivel më të ulët të vullnetarizmit për dallim nga burrat. Hendeku gjinor është i dukshëm në radhët e të gjitha grup moshave. Për shembull, 16.3 përqind e burrave krahasuar me 11.1 përqind të grave, raportuan se kishin dalë vullnetarë në tre muajt e fundit të vitit 2017.

Për më tepër, anketa e vitit 2017 tregon se në Kosovë, vullnetarët janë kryesisht të rinj, që vijnë kryesisht nga grupmosha 18-24 vjeç, p.sh., që përbën 14.3 përqind të atyre që kanë qenë vullnetarë në vitin e kaluar. Sa i përket kohës, nga ata që janë të gatshëm për të dalë vullnetar nëse i jepet mundësia, më shumë se një e treta do të dilnin vullnetar deri në 10 orë ose dy ditë pune në muaj (34.9 përqind), 5.3 përqind do të dilnin vullnetar deri në 20 orë ose katër ditë pune dhe vetëm 2.1 përqind do të ishin të gatshëm të dalin vullnetarë më shumë se 25 orë ose më shumë se pesë ditë pune.






Figura 1. Dinamikat e vullnetarizmit në Kosovë

Burimi: Studimi 2017 i D4D-së.

## Motivimi për vullnetarizëm: Vlera kundrejt motiveve individuale

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se vullnetarizmi qëndron në mes të motivimit për shkak të vlerave dhe motiveve individuale. Me një rënie nga rezultatet paraprake të studimit, nga 80.6 përqind në vitin 2016 në 75.8 përqind në vitin 2017, motivimi kryesor për vullnetarizmin është për të dhënë kontribut për komunitetin. Në të vërtetë, këto të dhëna e vendosin Kosovën lartë sa i përket motivimit altruist. Megjithatë, motivet për vullnetarizëm janë po ashtu individuale. Ato përfshijnë dëshirën për të rritur kapitalin social përmes punës në rrjet (41.4 përqind), perspektivat e punësimit (40.5 përqind), e pasuar nga motivi i arsimit (37.2 përqind).




Figura 2. Fushat e vullnetarizmit në Kosovë

Burimi: Studimi i vitit 2017 i Demokracisë për Zhvillim.

Në krahasim me të dhënat nga anketa e vitit të kaluar, ku fushat e vullnetarizmit duket se përfshijnë kujdesin për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të moshuarit (43-46 përqind), e pasuar nga programet e shoqërisë civile (33 përqind) (Sutaj dhe Vidačak 2017, f. 27), është vërejtur një ndryshim në vitin 2017. Këtë herë, është arsimimi që është fusha kryesore për vullnetarizmin e ndjekur nga zhvillimi i komunitetit, mjedisi, kultura etj. (shih Figurën 2). Arsimi ishte fusha e dytë në anketën e vitit 2016.




Figura 3. Vështrime mbi rolet e vullnetarizmit

Burimi: Studimi 2017 i D4D-së.

Ndonëse motivet për vullnetarizëm janë të ndryshme, edhe rolet që vullnetarët i përshkruajnë vetë ndryshojnë. Siç

tregohet në Figurën 3, 41.3 përqind do të donte që të kenë një rol në aktivitetet organizuese për dallim nga 32 përqind që preferojnë të mos kenë asnjë rol të veçantë. Përderisa 22,3 përqind e vullnetarëve e perceptojnë veten e tyre si me rol në mbledhjen e fondeve për organizatat me bazë në komunitet, pothuajse e njëjtë - 22,2 përqind - thonë se dëshirojnë të kenë një rol administrativ, që pasohet nga stërvitja e fëmijëve dhe e rinjve. Tre rolet e preferuara në vullnetarizëm janë logjistika (13.6 përqind), vullnetarë në kuadër të një fushe të ekspertizës (13.3 përqind), dhe në fund financat, me 13.2 përqind.

Në përgjithësi, besohet se nga vullnetarizmi ka dobi të shumëfishtë për OJQ-të dhe OSHC-të. Vullnetarizmi i mobilizon qytetarët rreth misionit të organizatës; Ai rrit efektivitetin e një organizate, dhe gjithashtu kursen kohë dhe burime të tjera. Siç deklaroi një pjesëmarrës në DFG:

“Kemi një grup vullnetarësh në të cilët ne mbështetemi për të marrë një sasi të caktuar të punës në projektin tonë të shkollës. Vullnetarët që vijnë në projekt gjithashtu mund të bëhen edhe anëtarë. Organizata jonë bazohet në anëtarësim dhe në këtë mënyrë vullnetarizmi është një mekanizëm jo vetëm që bën të mundur zbatimin e suksesshëm të projektit, por edhe e zgjeron anëtarësinë tonë, dhe kështu farkëton një lidhje më të ngushtë në mes organizatës dhe komunitetit” (udhëheqës i një OJQ-je nga Peja).

Megjithatë, konstatimet e anketës dhe DFG kanë treguar se sfidat e vullnetarizmit, kanë të bëjnë me kornizat sociale dhe institucionale. Ato përfshijnë: mungesën e vetëdijes, mungesën e informacionit rreth mundësive për vullnetarizëm, mungesës së rregulloreve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve, mungesën e stimuljeve për vullnetarët si dhe mungesën e një kulture të njohjes së vullnetarizmit.

---

## Rekomandimet

### *Qeveria e Kosovës*

- Duhet të hartohet Ligji për Vullnetarizmin për të lejuar vullnetarët që vijnë nga shtresa të ndryshme shoqërore, socio-ekonomike dhe nga identitete dhe sektorë të ndryshëm që të angazhohen në aksione vullnetare dhe që kontributi i tyre t'u njihet. Ligji duhet të rregullojë të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve dhe të organizatave vullnetare. Ligji duhet të përcaktojë se si dhe deri në çfarë mase institucionet publike duhet të angazhojnë vullnetarë në aktivitetet e vullnetarizmit në dobi të mirëqenies shoqërore.
- Qeveria duhet të zhvillojë një strategji kombëtare mbi vullnetarizmin përmes një procesi pjesëmarrës së bashku me sektorin e shoqërisë civile, komunitetet, institucionet publike dhe aktorët ekonomikë.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) duhet të integrojë vullnetarizmin në strategjinë e arsimit në Kosovë. Vullnetarizmi duhet të integrohet në të kurrikulat (plan-programet) e shkollave në të gjitha nivelet e arsimit dhe projektet e shkollave.

### *Shoqëria civile*

- Akterët e shoqërisë civile dhe të institucioneve akademike duhet të vazhdojnë përgatitjen dhe ofrimin e programit të trajnimit mbi vullnetarizmin.
- Trajnimi duhet të jetë i hapur dhe i disponueshëm për publikun e gjerë.
- Mbledhja e të dhënave, analizimi, monitorimi dhe raportimi i vullnetarizmit duhet të bëhet në baza të rregullta nga shteti, shoqëria civile dhe organizatat e biznesit.

- Një platformë vullnetare online e pacaktuar duhet t'u lejojë vullnetarëve që kanë më shumë se 24 vjeç të regjistrohen.
- Sektori i shoqërisë civile duhet të nxisë dialogun publik mbi të drejtat qytetare, barazinë, solidaritetin dhe reciprocitetin.
- OSHC-të duhet angazhohen në projekte për ngritjen e vetëdijes mbi çështjet sociale si platformë për vullnetarizëm.
- OSHC-të, institucionet publike, bizneset dhe komunitetet duhet ta promovojnë dhe ta njohin vullnetarizmin.
- OSHC-të duhet të vazhdojnë ta promovojnë vullnetarizmin dhe ta mbështesin pjesëmarrjen qytetare në nivel të komunitetit. Vëmendje duhet t'u kushtohet çështjeve gjinore dhe diversitetit. Gratë dhe pakicat etnike duhet të inkurajohen që të angazhohen në iniciativa që bazohen në komunitet dhe në projektet vullnetare.
- Institucionet publike, veçanërisht në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, së bashku me sektorin e biznesit duhet të hapen për projekte dhe iniciativa të vullnetarizmit.
- OSHC-të duhet të ngrisin në shkallë më të lartë rrjetëzimin dhe vullnetarizmin ndërkombëtar për t'u mundësuar vullnetarëve të Kosovës që të angazhohen në projektet vullnetare në rajon, Evropë dhe më gjerë. Vullnetarët e Kosovës do të përfitonin nga shkëmbimi i përvojave dhe do të ishin më të pajisur për trajtimin e çështjet sociale në nivel mikro, duke ruajtur perspektivën makro. Vullnetarizmi ndërkombëtar do të thyente çdo ndjenjë të izolimit dhe po ashtu do të kontribuonte në kulturën e kozmopolitizmit.

---

## Përfundim

Vullnetarizmi në Kosovë ka marrë një rol në politikat publike dhe ka formësuar aktivizmin e shoqërisë civile. Hulumtimet mbi vullnetarizmin po dalin gjithnjë e më shumë në pah, duke mundësuar një të kuptuar kritik të aktorëve, praktikave, motiveve, fushave dhe hapësirave për aksion vullnetar. Vullnetarizmi konsiderohet si politikë me prioritet për fuqizimin e rinisë, dhe po ashtu është bërë një objektiv kyç në strategjinë e shtetit për bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Sidoqoftë, ende ka nevojë për më shumë rregullim për të lejuar vullnetarizmin të lulëzojë në tërë sektorin publik, shoqërinë civile dhe biznes. Në të vërtetë, në çdo hap të ardhshëm drejt rregullimit të lëmisë së vullnetarizmit duhet të bëhet përpjekje për koherencë të objektivave për të përmbushur nevojat e vullnetarëve, si dhe për të siguruar të drejtat dhe përgjegjësitë për vullnetarët dhe organizatat vullnetare. Për më tepër, një qytetari që angazhohet përmes vullnetarizmit duhet të marrë parasysh çështjet gjinore dhe diversitetin për t'u mundësuar të gjithë qytetarëve me prejardhje të ndryshme që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në çështjet e komunitetit dhe publike.

Ndonëse përmirësimi i kuadrit ligjor për vullnetarizmin është i rëndësishëm, po aq e rëndësishme është mbështetja e angazhimit qytetar për t'i identifikuar dhe për t'i trajtuar çështjet me interes publik. Të dhënat e hulumtimit kanë treguar se vullnetarizmi perceptohet kryesisht në aspektin altruist - një praktikë me një qëllim social – të orientuar drejt komunitetit, që pasohet nga motive individuale që lidhen me punën në rrjet, arsimin dhe perspektivat e punësimit. E kuptuar në këtë mënyrë, vullnetarizmi mbart një potencial për të nxitur kulturën e solidaritetit dhe të reciprocitetit, si dhe për të rritur ndërveprimin mes qytetarëve dhe komuniteteve me akterët shtetërorë dhe jo-shtetërorë në çështjet publike. Shoqëria civile duhet të luajë një rol të rëndësishëm për shfrytëzimin e përvojave dhe për të kontribuar për atë qëllim.

## Lista e publikimeve

### Zgjedhjet dhe partitë politike

- #1 Instituti D4D. Shtator 2011. Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.
- #2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si ta kthejmë besimin në zgjedhje?
- #3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën A.
- #4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme: Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj and Kaçanik.
- #5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit dhe perceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.
- #6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Reforma Zgjedhore: Dy vite pas, reforma në pikën zero
- #7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busulla ideologjike e Kosovës – Harta e orientimit të partive politike
- #8 Dardan Berisha me kontribut nga Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, Korrik 2015. Vendosja e drejtësisë në zgjedhje
- #9 Leon Malazogu me kontribut nga Ngadhnjim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015. Trendet Zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit
- #10 Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi, shkurt 2016 Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor



## Rekomandimet e Forumit Reforma

- #1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KQZ-së
- #2 E hartuar nga Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi Zgjedhor
- #3 E hartuar nga Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Korrigjimi i listës së votuesve
- #5 E hartuar nga Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandime për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës
- #6 Mbështetur nga: D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Për Reformë të Mirëfilltë Zgjedhore

## Dialogu dhe bashkëpunimi rajonal

- #1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd-Prishtinë: Nevojitet transformimi i interesit vetanak. PER-K/Instituti D4D dhe NPC-Beograd
- #2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva për serbët e rinj në Kosovë. Jeta urbane në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.
- #4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Shtator 2012. Raportet në mes të Prishtinës dhe Beogradit në të ardhmen. PER-K/ Instituti D4D.
- #5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv: Si t'i qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D
- #6 Ejđus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës: Drejt një baraspeshe të re? E publikuar bashkërisht nga CEPI, BCSP dhe D4D.
- #7 Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Ajete Kërçeli. Me kontribut nga: Shpend Emini, Rezarta Delibashzade dhe Ferid Murseli. Gratë e fuqizuara: Çelës për transformimin e komuniteteve.

## Qeverisja dhe interesi publik

- #1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. Taksa e fshehur: Pse kosovarët paguajnë më shumë?
- #2 Gashi, Drilon dhe Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë
- #3 Sutaj, Visar dhe Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngritet shoqëria civile e vërtetë! Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendim-marrjes në shërbim të interesit publik
- #4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit: Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë. Miftari, Naser. 2013. Fillimi nga zeroja: Roli i asistencës së medias në krijimin e institucioneve të pavarura të medias në Kosovë. Dokument pune 4, i publikuar nga Analitika – Qendra për hulumtime sociale dhe D4D – Demokraci për Zhvillim.
- #5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnmj Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati.
- #6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi Roli i grupeve të interesit: Praktikrat më të mira, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra
- #7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor 2015 Reformimi i Universitetit të Prishtinës - Mision i mundur?
- #8 Leon Malazogu dhe Bernard Nikaj; me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor 2016. Nxitja për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë
- #9 Jehona Serhati; me kontribut në redaktim nga Abby Riley. Janar 2017. Stimuj për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit dhe të diplomuarit e AAP-së në tregun e punës
- #10 Isuf Zejna. Korrik 2017. Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas.
- #11 Visar Sutaj, tetor 2017. Sa të pavarura janë autoritetet

rregullatore në Kosovë?

- #12 Abazi-Morina, Linda dhe Delibashzade, Rezarta. Me kontribut të: Kërqeli, Ajete dhe Zogjani, Valëza. Nëntor 2017. Mosaktivizimi i grave në tregun e punës – Faktorët që e pengojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.
- #13 Kërqeli, Ajete. Me kontribute nga Gashi, Ardiana. Dhjetor 2017. Ndryshimi i paradigmës – Barazi përmes lejes prindërore.

**Memorandumet reaguese**

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Memorandumi reagues nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë
- #2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Memorandumi reagues nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive
- #3 Instituti D4D. 12 korrik 103. Memorandumi reagues nr. 3 – Kriteria të qarta për komunat e reja
- #4 Instituti D4D dhe Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandumi reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rrethin vicioz
- #5 Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandumi reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore
- #6 Instituti D4D. Nëntor 2016. Memorandumi reagues nr. 6 – Reforma zgjedhore

**Treguesit dhe skenarët**

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe pas performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010
- #2 Instituti D4D. Shteti në pasqyrë: Indikatorët e bazuar në performancë.
- #3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do t'i sjellë palët më afër në lidhje me asociacionin/bashkësinë

## Referencat

Gallup. (2016). *Global Civic Engagement*. E nxjerrë nga <http://www.shqiperiajone.org/sites/default/files/pdf/2016%20Global%20Civic%20Engagement%20Report.pdf>

Instituti GAP. (2017). *Roli dhe rëndësia e qytetarisë aktive*. E nxjerrë nga [http://www.institutigap.org/documents/7607\\_organizedcommunities.pdf](http://www.institutigap.org/documents/7607_organizedcommunities.pdf)

Çeku, Hajrulla. (2013). *Analizë: Vullnetarizëm për Zhvillim. Zhvillimi i Kornizës Ligjore për Njohjen e Vullnetarizmit në Kosovë*. E nxjerrë nga [http://www.civikos.net/repository/docs/PAPER\\_Vullnetarizmi\\_634317\\_965999.pdf](http://www.civikos.net/repository/docs/PAPER_Vullnetarizmi_634317_965999.pdf)

Howard, Clark. (2000). *Civil Resistance in Kosovo*. London: Pluto Press.

Hoxha, Taulant. (2016). *Indeksi Kosovar i shoqërisë civile 2016*. E nxjerrë nga [http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/05\\_11\\_2016\\_4070877\\_Indeksi\\_Kosovar\\_i\\_shoqërisë\\_civile\\_2016\\_KCSF.PDF](http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/05_11_2016_4070877_Indeksi_Kosovar_i_shoqërisë_civile_2016_KCSF.PDF)

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2016). *Anketë për fuqinë punëtore të Kosovës, 2016*. E nxjerrë online nga: <http://ask.rks.gov.net/media/3245/lfs-2016-anglisht.pdf>

Kuvendi i Kosovës. (2009). *Ligji nr. 03/L-145 për Fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve*. I nxjerrë nga <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-145-eng.pdf>

Qeveria e Kosovës. (2013). *Strategjia Kosovare për Rininë 2013-2017*. E nxjerrë nga [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_Kosovare\\_per\\_Rinine\\_2013-2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kosovare_per_Rinine_2013-2017.pdf)

---

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. (2016). Udhëzimi Administrativ nr. 01/2016 mbi Punën vullnetare të rinjve. E nxjerrë nga <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15172>

Zyra për Qeverisje të Mirë. (2013). *Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017*. E nxjerrë nga [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_qeveritare\\_per\\_bashkepunim\\_me\\_shoqerine\\_civile\\_drafti\\_perfundimtar2.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_qeveritare_per_bashkepunim_me_shoqerine_civile_drafti_perfundimtar2.pdf)

Sutaj, Visar dhe Vidačak, Igor. (2017). *Krijimi i një ambienti më mundësues për vullnetarizëm në Kosovë. Studimi mbi vullnetarizmin në Kosovë*. Prishtinë: Demokracia për Zhvillim.

Sutaj, Visar. (2017). *Krijimi i një ambienti më mundësues për vullnetarizëm në Kosovë. Studimi mbi vullnetarizmin në Kosovë. Document politikash*. Prishtinë: Demokracia për Zhvillim.

UNDP. (2004). *Ngritja e qytetarit: Sfidat dhe mundësitë. Raporti i zhvillimit njerëzor Kosovë 2004. Raporti i Zhvillimit Njerëzor Kosova 2004*. I nxjerrë nga [http://hdr.undp.org/sites/default/files/kosovo\\_2004\\_en.pdf](http://hdr.undp.org/sites/default/files/kosovo_2004_en.pdf)

Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

331.314(496.51)(047)

Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë : sfidat dhe perspektivat / punimi i përgatitur nga Vjollca Krasniqi.  
– Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2018. – 31 f. ; 21 cm. – (Seria : Interesi publik ; 14)

1.Krasniqi, Vjollca

**ISBN 978-9951-608-67-1**



Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një shoqëri aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë në hapësirën publike dhe e përdor atë për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e burimeve të cilat janë efëiente, të shpejta, afat-gjate dhe që sjellin zhvillim të paanshëm.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org).

*Ky punim qëndrimesh u financua nga:*



British Embassy  
Pristina

ISBN 978-9951-608-67-1

